

Tiranë më, 30 Janar 2023

Lënda: Kërkesë për informacion  
Drejtuar: Z. Ergys Verdho  
Korporata Elektroenergjitike Shqiptare

Përshëndetje Z. Verdho,

Në vijim të bashkëpunimit me të gjitha institucionet shtetërore dhe duke u mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT, kërkojmë informacion në lidhje me termocentralet lundruese të prodhimit të energjisë të vendosura në Vlorë, pas tenderimit nga ana juaj dhe shpalljes së fituesit të këtij tenderimi nga bashkimi i operatorëve ekonomikë Excelerate Energy and Renco si vijon:

- Dokumentacionin ligjor mbi të drejtat e përdorimit apo pronësisë së asetit gjenerues që ofrohet për dhënie me qera bazuar në VKM-në Nr. 620, datë 22.10.2021, *Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin e parandalimit të saj*, pika 14. gërma a), si dhe informacionin si më poshtë:
  - Nipt-in, ekstraktin dhe adresën e kompanisë fituese.
  - Koston e qerasë në total lidhur me këto dy termocentralet lundruese
  - Kontratën e qerasë ndërmjet KESH dhe kompanisë fituese.

Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin,

Në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj,

Autor i Emisionit